



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare*

UDHËZUESI NUMËR 17

**SANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE
PËR TË MITURIT QË HYJNË NË MARTESË**

STANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE PËR MITURIT QE HYJNË NË MARTESË

QËLLIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE PËR MITURIT QE HYJNË NË MARTESË

Qëllimi i shërbimeve sociale për të miturit që hyjnë në martesë është promovimi i mundësive për zhvillimin e personalitetit të tyre dhe mështetja e tyre për mos të qenë të përjashtuar nga zhvillimet shoqërore.

GRUPET PRIORITARE

Grupet prioritare:

- Të miturit e moshës mbi 16 -18 vjeç

PARIMET KRYESORE

- Prioriteti absolut i interesave më të mira të fëmijës
- Ndërtimi i besimit
- Konfidencialiteti
- Ofrimi i shërbimeve pa diskriminim gjinor, etnik ose religjioz

AKTIVITETET KRYESORE TË SHËRBIMIT SOCIAL PËR TË MITURIT QË HYNË NE MARTESË

Aktivitetet vijuese që do të zhvillohen:

- Sigurimi i informatave
- Sigurimi i mbështetjes sociale
- Sigurimi i asistencës psikologjike
- Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave

STANDARDET MINIMALE

Standardet minimale strukturale	Indikatorët e performancës
X.1.1 Shërbimet sociale-psikologjike për të miturit që hyjnë në martesë e moshës do të ofrohen nga ofrues të shërbimeve sociale të licencuar dhe psikolog të licencuar.	<ul style="list-style-type: none">• Licencat valide të specialistëve
X.1.2 Ofruesit e shërbimeve sociale do të trajnohen në mënyrë specifike për të ofruar shërbime për të miturit që hyjnë në martesë	<ul style="list-style-type: none">• Dëshmi të trajnimeve përkatëse
X.1.3 Çdo ofrues i shërbimeve sociale dhe psikolog që do të punojë me të miturit që hyjnë në martesë do të ketë jo më tepër se 3 raste aktive të kësaj kategorie.	<ul style="list-style-type: none">• Ofruesi i shërbimit social / raste aktive;• Psikologë/ raste aktive;

X.1.4 Konsultimi dhe trajtimi social/psikologjik do të zhvillohen në hapësirë të përshtatshme dhe të përshtatshme për të miturit që hyjnë në martesë.	<ul style="list-style-type: none"> Zyrat e mobiluar në mënyrë adekuate dhe të dedikuara për trajtime socio-psikologjike
X.1.5 Shërbimet sociale për të miturit që hyjnë në martesë do të sigurohen nga Qendrat e Punës Sociale.	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloret e brendshme
X.1.6 Ofruesit e shërbimeve sociale të cilët ofrojnë shërbime për të miturit që hyjnë në martesë do të plotësojnë kërkesat e standardeve minimale strukturale të definuar për llojet e organizatave ofruese të shërbimeve specifike.	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloret e brendshme Vlerësimi në raportet e monitorimit Licenca Valide
Standardet funksionale	Indikatorët e performancës
X.2.1 Të gjitha veprimet e ofruesit të shërbimit do të bazohen në interesat më të mira të të miturit/ës dhe do të synojnë mbrojtjen e të drejtave të tij/saj.	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloret e brendshme. Njohuri mbi legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor për të drejtat e fëmijës.
X.2.2 Ofruesi i shërbimit social do të informojë të miturin/en rreth objektivave dhe mënyrave të intervenimit profesional si dhe rolin e specialistëve të cilët do të punojnë me të miturin. Informatat do të sigurohen duke marrë parasysh kushtet psikologjike,shëndetësore,moshën, gjininë dhe religjionin e të miturit.	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloret e brendshme Profesionistët e trajnuar
X.2.3 Ofruesi i shërbimit social do të sigurojë informata adekuate për prindin/ërit kujdestarin e të miturit/es rreth objektivave dhe mënyrave të intervenimit profesional si dhe rolin e profesionistëve të cilët do të punojnë me të miturin dhe anëtarët e familjes.	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloret e brendshme
X.2.4 Çdo të mituri/e të cilit i ofrohen shërbime sociale do të caktohet menaxheri i rastit. Menaxheri i rastit do të ofroj shërbime, dhe monitorojë punën e ekipit multi-disiplinor.	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësim në raportet e monitorimit
X.2.5 Ofruesi i shërbimit do të zhvillojë një vlerësim të plotë të nevojave të të miturit. Vlerësimi i nevojave do të përfshijë nevojat sociale,psikologjike, edukative, shëndetësore dhe nevojat për mbështetje ligjore.	<ul style="list-style-type: none"> Forma për vlerësimin e nevojave, ku reflektohen nevojat e vlerësuara
X.2.6 Konkluzioni/rekomandimi për pajtueshmërinë për martesën e të miturve duhet të dërgohet në gjykatë jo më herët se 7 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë nga ofruesi i shërbimeve sociale nga dita e referimit të kërkesës nga gjykata.	<ul style="list-style-type: none"> Shënime të brendshme.
X.2.7 Intervenimi profesional dhe mbështetja do të sigurohen sipas një Plani Individual i Shërbimeve, i mbështetur në bazën e nevojave të vlerësuara. Plani individual i shërbimeve do të hartohet nga	<ul style="list-style-type: none"> Plani individual me të gjitha veprimet e specifikuar

menaxheri i rastit dhe ekipi multi-disiplinor me pjesëmarrjen e të miturve që hyjnë në martesë dhe prindit/ëve/kujdestarit legal.	
X.2.8 Ofruesi i shërbimit do të sigurojë konfidencialitetin e detajeve të rastit. Informatat konfidenciale do të ndahen vetëm për trupat e autorizuar me pajtimin e të miturit dhe prindërve ose përfaqësuesve ligjor të tij/saj.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret brendshme e • Vlerësim në raportet e monitorimit
<p>X.2.9 Çdo të mituri që i ofrohen shërbimet sociale do të ketë dosjen e vet individuale ku do të përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dokumentet e identifikimit • Dokumentet mjekësore • Kërkesa e gjykatës përkatëse për ekzaminim • Forma e vlerësimit të nevojave me nevoja të vlerësuara • Plani individual i shërbimeve (i rishikuar sipas nevojës) 	<ul style="list-style-type: none"> • Dosja individuale me dokumentet relevante
X.2.10 Çdo veprim individual apo grupor për të miturin/ren do të kryhet duke marrë parasysh moshën, gjendjen fizike, emocionale dhe psikologjike të të miturit/resë.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret brendshme e • Vlerësimi në raportet e monitorimit
X.2. 11 Sipas nevojës, bazuar në vlerësimin e Planit Individual të Shërbimeve ofruesit e shërbimit do të pajtohen me të miturin/ën dhe prindin/ërit kujdestarë, përfaqësues ligjor për sa i përket formave të mbikëqyrjes se me tutjeshme të rastit.	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret brendshme e • Dëshmi mbi marrëveshjet